

**Faqe e parë**

PRINT KOMENTO

**KERKIM**

**LAJMET E FUNDIT**

|                              |
|------------------------------|
| <b>KRYESORE</b>              |
| Politike                     |
| Analiza&Komente              |
| Kronike                      |
| Kulture                      |
| Dossier                      |
| Reportazh                    |
| Sociale                      |
| Ekonomi                      |
| Rrethet                      |
| Speciale                     |
| Urbane                       |
| Kosovë                       |
| Metropol in English          |
| Intervista                   |
| Aktualitet                   |
| Histori                      |
| Rajon                        |
| <b>KOHE E LIRE</b>           |
| Debat                        |
| Komente per rubriken "Debat" |

## Nëndetësja gjermane, mbyti 92 vjet më parë "Re Umberto" dhe "Intrepido"

**DHIMITËR SPIRO**

**01/10/2007** Gjenden dy anije italiane të mbytura gjatë Luftës së Parë Botërore në Gjirin e Vlorës

Në Gjirin e Vlorës, janë zbuluar dy anije të tjera italiane të cilat janë mbytur në Luftën e Parë Botërore.

Ka qenë Drejtori i Departamentit të Arkeologjisë Nënujore dhe Detare të Institutit Kombëtar të Arkeologjisë në Tiranë, Dr. Adrian Anastasi si dhe Presidenti i Shoqërisë Ndërkombëtare të Zhytësve Profesionistë (IANTD) të cilët kanë dhënë lajmin ditën e djeshme për këtë zbulim të rëndësishme arkeologjike.

Anijet e mbytura

Dy anijet "Re Umberto" që transportonte trupa ushtarake dhe anija luftarake "Intrepido" ishin mbytur në datën 4 dhjetor të viti 1915. Anijet fillimisht janë lokalizuar prej Cesare Balzi, instruktori i Agjencisë Didaktike IANTD. Lokalizimi i tyre u mundësua në bazë të të dhënave të sakta historike e shkencore të siguruar pas një marrëveshje bashkëpunimi italo-shqiptar me temë "Kërkimi dhe identifikimi i mbetjeve të anijeve të epokës bashkëkohore dhe moderne me qëllim vlerësimin kulturor, turistik dhe nënujor të bregdetit shqiptar", marrëveshje e cila është firmosur prej Departamentit Arkeologjik Nënujor dhe Detar të Institutit të Arkeologjisë në Tiranë dhe të Shoqërisë IANTD me bazë në Marina di Pisa në Itali. Projekti është drejtuar prej Dr. Adrian Anastasit, i caktuar nga instituti i Arkeologjisë për palën shqiptare si dhe instruktor dhe trajnues Cesare Balzi.

Ekspedita për evidentimin e anijeve të mbytura ka nisur që prej 4 ditësh dhe gjatë kësaj kohe janë filmuar dhe fotografuar pjesët e të dy anijeve të mbytura. Ekspedita do të përfundojë pas tre ditësh.

Sipas një prej përfaqësuesve të Shoqatës së Zhytësve "Ekspedita Blu" që kryen mbështetjen logjistike, Genci Kapllani, mësohet se, Gjiri i Vlorës fsheh relike të shumta të anijeve italiane me një rëndësi të veçantë historike, të cilat janë fundosur gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Lokalizimi dhe identifikimi i tyre merr rëndësi shkencore për të dyja vendet.

Sipas Dr. Adrian Anastasit, mësohet se, "zbulimi i këtyre veprave do të jetë një pasuri nënujore me vlera të mëdha për vetë qytetin e Vlorës".

Historia e mbytjes

Dy anijet e mbytura, anija "Re Umberto" që transportonte Trupa Luftarake, ishte duke hyrë për në Shqipëri. Në bazë të të dhënave historike, mësohet se, duke qenë se pjesa që prej ishullit të Sazanit dhe deri në afërsi të Vlorës, pranë Zvërnecit, ishte e minuar me qëllim që forcat gjermane mos të hynin në gji, forcat e ushtrisë italiane kishin lënë të hapur vetëm ngushticën mes Karaburunit dhe Sazanit. Ky informacion, siç duket i kishte vajtur edhe gjermanëve të cilët nisën në mënyrë të fshehtë nëndetësen UC 14 e cila u nis nga Turqia. Kjo nëndetëse kishte bërë minimin e zonës me mina nën ujore të cilat ishin vendosur në ngushticën e lënë për të kaluar mjetet ujore italiane. Si pasojë e shpërthimit të njëres prej minave, ka qenë anija "Re Umberto" e cila rreth orës 10.00 të mëngjesit të datës 4 dhjetor të vitit 1915 është ndarë në dy pjesë, pozicion në të cilën është gjetur dhe dje.

Sipas ekipit arkeologjik në të janë mbytur rreth 60 persona.

Pas marrjes së sinjalit për mbytjen e anies. nga Italia është nisur ania

**1 Shtator, 16:20**  
Italia pro pavaresise se Kosoves

**1 Shtator, 16:00**  
Nis ndarja e librave shkollore

**1 Shtator, 15:05**  
Rama kerkon hetime per KESH dhe rrugen Durres Kukes Morine

**1 Shtator, 14:10**  
Gramsh, arrestohet nje person per prodhim lendesh narkotike

**14 Gusht, 16:25**  
Perplaset me makinën, vdes 35 vjecarja

**14 Gusht, 15:20**

### KURSI I KEMBIMIT

**15 Shtator**

|             | BLEJ         | SHES         |
|-------------|--------------|--------------|
| <b>USD</b>  | <b>89.9</b>  | <b>90.9</b>  |
| <b>EURO</b> | <b>121.1</b> | <b>121.8</b> |
| <b>GBP</b>  | <b>178.2</b> | <b>180.4</b> |
| <b>CHF</b>  | <b>74.4</b>  | <b>75</b>    |

#### SONDAZH

Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohëshme, apo president nga populli?

- Do gjendet konsensusi?
- Shkojmë në zgjedhje të reja?
- Do vendos vota e popullit?
- Nuk e di?
- 

|                      |
|----------------------|
| <b>NDIHMESA</b>      |
| Kush Jemi            |
| Kontakt              |
| Abonime              |
| Reklama Web          |
| Reklama Gazete       |
| Sygjerime dhe ankesa |
| Stafi                |



tjetër luftarake "Intrepido" e cila ka takuar në të njëjtin minim, dhe është mbytur rreth orës 17.00 të po asaj date. Sipas arkeologëve, në këtë anija janë mbytur 5 marinarë.

Më pas nëndetësja gjermane është larguar ku sipas dokumenteve historike është mbytur pas rreth 3 vjetësh në Belgjikë si pasojë e një defekti.

Sipas ekipit që u morr me studimin, kanë qenë të dhënat e mbledhura në mënyrë të saktë si dhe studimi i anijeve me përpikëri, të cilat kanë sjellë dhe do të sjellin në dritë të dhëna shumë të sakta dhe të tjera, në lidhje me kohën kur ka ndodhur mbytja, shkaku, personat që janë mbytur në të si dhe një sërë faktesh të reja. Në pamjet e marra prej operatorit italian, Massimiliano Cannussa, duken pjesët e anijeve të mbytura, ku në disa pjesë dallohen dhe struktura, pjesët dhe disa detaje të tyre.

Anija "Re Umberto" është gjetur në thellësinë 50 metra ndërsa anija tjetër "Intrepido" në thellësinë 30 metra.

Sipas Dr. Adrian Anastasit, mësohet se vazhdimi i kërkimeve në këtë fushë, do të bëjë të mundur krijimin e një harte, mbi vendndodhjen e anijeve të mbytura përgjatë dy luftërave.

Vitin e kaluar, në afërsi të vendit ku u gjetën anijet, u gjet e mbytur dhe anija Spital, "Regina Margerita" ku së bashku me atë u mbytën mbi 600 veta.

|                     |
|---------------------|
| <b>SPORTIVE</b>     |
| Aktualitet Sporti   |
| Kupa e Shqipërisë   |
| FSHF                |
| Kategoria Superiore |
| Kategoria e Pare    |
| Kategoria e Dytë    |
| Leqjonaret          |
| Lojra               |
| Kombetarja          |
| Kampionati Italian  |
| Kampionati Anglez   |
| Kampionati Gjerman  |
| Kampionati Spanjoll |
| Kupa UEFA           |
| Liqa e Kampioneve   |
| Formula 1           |
| Miks Futboll Bota   |
| Shumesport Bota     |
| Gossip              |



|                |
|----------------|
| <b>MODA</b>    |
| Moda           |
| Make-up        |
| Shendeti       |
| Kuriozitet     |
| Personazhe Vip |



**Faqe të dobishme**

vitrinat  
albaniaonline  
Albanian Books  
La Repubblica

Corriere della Sera  
Mergimtari  
Alb-Shkenca  
BBC Albania  
VOA News  
Babel  
Ministria e Arsimit  
TanPortal  
Trepça  
Green Card Llotary

---